



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0930

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërje nga Batisha Ibrahim, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE "Internat Security Association"SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-2841-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, më 04/12/2024, mori këtë:

Vendim

- 1.Aprovohet si pjesërishte e bazuar ankesa e OE "Internat Security Association"SH.P.K me nr. 2024/0930, e datës 01/10/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-2841-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
- 2.Mbetet në fuqi B58Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë, në lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
- 3.Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Internat Security Association"SH.P.K”.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 25.03.2024 Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-2841-2-2-1.

Ndërsa me datën 18.09.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “KSF MAJOR SH.A.”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 88,000.00 €.

Me 21.09.2024 OE "Internat Security Association" SH.P. K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 23.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 01.10.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Internat Security Association" SH.P.K me nr. 0930/2024 lidhur me aktivitetin "Sigurimi Fizik i Objekteve te Institutit Special në Shtime" me numër të prokurimit 206-24-2841-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Internat Security Association" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “Meqenëse se ne jemi kompani me interes në këtë AP po e parashtrojmë këtë ankesë duke pas parasysh se kompania jonë ka dal me një ofertë të detajuar përmes një analize të kërkuar në dosjen e tenderit ku kanë qenë të përfshira të gjitha obligimet ligjore të dala nga ligji I punës së Republikës së Kosovës dhe veçanërisht neni 56 të këtij ligjit të cilën kërkesë e kemi përmbushur në tërësi sipas kërkesës së dhënë te dosja e tenderit nga AK respektivisht te ankesa 1 specifikimet teknike të detyrueshme të cilën po e bashkëngjisim këtu me shpresën për të dëshmuar më tej se OE Major nuk i plotëson as për së afërmi këto kërkesa të përlllogaritje së çmimit në ofertën e tij . “Ofruesi i Shërbimeve gjate realizimit te kontratës do te respektoj Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 27 te ligjit te punës - Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate. Ndërsa sipas nenit 56 të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si: 30 % në orë për punë gjatë natës; 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 50 % në orë për punë gjatë fundjavës.” Kërkohej që kompania fituese të ketë minimumin 4 (punëtore) punëtor. Orari i punës: Instituti Special i Shtimes 24 ore / 7 dite te javës. Andaj me një llogaritje të thjeshtë e cila nuk ka ndonjë komplikim në llogaritje OE i shpallur fitues nuk ka llogaritur në kërkesat e AK e të cilat po I dëshmojmë me një kalkulim i cili është i thjeshtë që dëshmon tërësisht ankesën tonë: Paga e një punëtorit është kërkuar të jetë 350 euro neto pagë paga bruto është në vlerë prej : Paga neto 350 = paga bruto 385.36 euro ku janë të përfshira vetëm kontributet e punëmarrësit pastaj kalkulojmë pushimin vjetore 385.36 në muaj 29.19 Kalkulojmë më tutje 385.36+29.19 euro = 414.55 euro shtojmë kontributet nga punëmarrësi 20.73 euro që një pagë gjithsej vetëm me pushim vjetor kushton 414.55+20.73 euro 435.28 e që bëjnë 435.28*4 = 1741.11 euro x 36 muaj 62679.96 Llogarisim TVSH-në 18%= 11282.39 Totali i pagave plus TVSh 62679.96+11282.59= 73962.35 euro kurse oferta e OE fitues është nën këtë vlerë 73958.40 euro duke mos vazhduar më tej kalkulimin sipas kërkesës së AK (e cila është e qartë) më lartë OE I shpallur fitues nuk ka kalkuluar fare as orët shtesë të natës, as festat as vikendet obligim ky I dal me kërkesë të AK Andaj kërkojmë që ky AP të

anulohet dhe të kthehet në rivlerësim sepse jemi i vetmi OE i cili ka bërë të gjitha llogaritjet konform kërkesës së dosjes së tenderit të vendosura nga AK. AK ka refuzuar kërkesën tonë të bazuar për rishqyrtim me pretekstin se ne jemi duke kryer shërbimet me kushte të njëjta, mirëpo kushtet e vendosura në kontratën e negociuar nuk janë të njëjta me kërkesat në dosjen e tenderit për të cilin po bëjmë ankesën. Së pari paga minimale e kërkuar në kontratën e negociuar është 300 euro neto dhe ka një dallim prej 50 euro me pagën e kërkuar 350 euro neto në këtë AP, dhe normal që çmimi varion në kalkulim (bashkëngjitur gjeni edhe analizën financiare të kontratës së negociuar ku kemi llogaritur njësoj të gjitha obligimet e kërkuara), dhe ky nuk mund të konsiderohet si një arsye për refuzim të kërkesës sonë për rishqyrtim. Me këtë veprim AK ka bërë shkeljet e neneve të përmendura në këtë ankesë dhe edhe njëherë kërkojmë nga OSHP që ankesa jonë të mirret si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.”

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: “Konsiderojmë se pretendimet e juaja ankimore janë të pa bazuara, Ri-vlerësimi është bërë bazuar në Vendimin e PSH të OSHP-se me nr. 0550 si dhe tre Super ekspertizat e dhëna sipas tre ankesave që janë bërë për këtë aktivitet: Super-ekspertiza nr. 559 për ankesën Major, Super-ekspertiza nr. 550 për ankesën SAS, si dhe Super-ekspertiza nr. 566 për ankesën Internat Security Association. Bazuar në Vendimin e PSH të OSHP-se me nr. 0550 janë mbështetur rekomandimet e dhëna nga eksperti në super-ekspertizat e lartcekura. Vendimi i PSH të OSHP-se me nr. 0550 nder të tjera ka konstatuar se: Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatoreve Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorëve Ekonomik duhet të aprovohen si të bazuara ndërkaq vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe procedura e prokurimit të nënshtrohet rivlerësimit. Paneli shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore të ankueseve (të sipërcituar) kanë të bëjnë me OE të rekomanduar për kontrate ku sipas ekspertit shqyrtues i rekomanduar për kontratë ka dhënë totalin prej 85,843.58 derisa në analizën financiare sipas përlllogaritjes del se totali është 62,950.69 që rezulton se ka një ndryshim prej 22,892.9 me e vogël në analizë. Duke marr parasysh kërkesat e FDT ne të cilën është kërkuar që OE të ketë minimum 4 punëtor, llogaria e OE të rekomanduar për kontrate rezulton se është llogaritur vetëm për tre punëtor. Paneli shqyrtues vlerëson se AK nuk ka vepruar në harmoni me kërkesën e vet kur e ka përcaktuar mënyrën e kalkulimit në përshkrimin e çmimeve dhe se analiza financiare e kërkuar nuk ka një standard dhe mund të jetë subjektive për komisionin e vlerësimit. Sipas super-ekspertizave nr. 550, 559, 566 , eksperti shqyrtues ka rekomanduar si në vijim: Te papërgjegjshme ofertën BESA SECURITY SH.P.K. për arsye se: eksperti shqyrtues pas analizës së fakteve sqaron se me përshkrim të çmimeve OE i rekomanduar për kontrate ka dhënë totalin prej 85,843.58 derisa në analizën financiare sipas përlllogaritjes del se totali është 62,950.69 që rezulton se ka një ndryshim prej 22,892.9 me e vogël në analizë. Duke marr parasysh kërkesat e FDT ne të cilën është kërkuar që OE të ketë minimum 4 punëtor, llogaria e OE të rekomanduar për kontrate rezulton se është llogaritur vetëm për tre punëtor. Ka rekomanduar që AK nuk duhet të bazohet në Analiza financiare të brendshme të cilat nuk i janë prezantuar OE-ve gjatë fazës së tenderimit; Ka rekomanduar që Aktivitetit të rivlerësohet duke u marr për bazë kriteret e përcaktuara me FDT dhe ofertat e dorëzuara me analizën e OE -ve pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit e jo të merret një standard i cili nuk ka qenë pjesë e dokumenteve të tenderit në fazën e tenderimit dhe për të cilin OE nuk kanë pas njohuri. Eksperti shqyrtues vlerëson se në tabelën e pare ku është llogaritur gjithsejtë shpenzimi për pagën e një punëtori totali nuk është i sakte sepse është dashur të jete 404.63. Eksperti shqyrtues ka

rekomanduar që në tabelën e llogaritjes sipas AK-se gjatë llogaritjes së kontributeve AK në të tri ndërrimet e llogaritura ka llogaritur kontributin bazë e cila është në kundërshtim me LP 03 L/212 sepse kontributi llogaritet në pagën bruto e cila varësisht prej shtesave ndryshon dhe nuk mund të jetë e njëjtë sikur në tabelën e AK-se, rrjedhimisht duke dhënë një rezultat sipas të cilit është bazuar në vlerësimin e ofertave dhe e cila nuk ka qenë pjesë e FDT- së gjatë fazës së tenderimit e cila ka rezultuar që OE-te pjesë të këtij aktivitetit të prokurimit të trajtohen në mënyrë jo të barabartë dhe në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-se si dhe nenin 40.2 të RRPP 001/2022. AK-MSh, bazuar në dokumentacionin e lëndës, vendimin e PSH të OSHP-se nr. 0550, super-ekspertizat nr. 550, 559, 566, ka vendosur që oferta e rekomanduar KSF MAJOR SH.A. është e përgjegjshme, me çmimin me ulët 73,958.40 euro dhe është shpallur fitues, duke marrë parasysh edhe vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/218 të datës 28.08.2024 sipas të cilit nga data 1 tetor 2024 paga minimale është 350.00 euro, kjo është në përputhje me ofertën e OE, ku pjesë të ofertës e ka edhe deklaratën me shkrim se "...nëse e fiton tenderin, paga NETO e një punëtori të sigurimit fizik do të jetë 350.00 euro (minimumi)" Kontrata aktuale që është në implementim nga ana juaja me MSh, për të njëjtin institucion dhe për të njëjtin shërbim, me titull "Sigurimi fizik i objekteve të Institutit Special në Shtime" dhe nr. të kontratës 206-24-8096-2-3-5/C694, me të njëjtat kushte, ka vlerën mujore 1,992.00 €. Nëse për llogaritet 1,992.00 x 36 muaj = 71,712.00 euro. Oferta e OE të rekomanduar për muaj është 2,054.40 euro, ndërsa për 36 muaj është 73,958.40 euro, ose për 2,246.40 euro me e lartë se sa vlera e kontratës aktuale që kemi me juve, andaj konsiderojmë që nuk është e arsyeshme të kontestohet vlera o OE të rekomanduar, përderisa ju vet jeni duke e kryer të njëjtin shërbim me çmim edhe me të lirë."

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 08/10/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0930/2024, ndërsa me datë 19/10/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0930 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e papabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Internat Security Association" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0930 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I) : "Sipas vendimit të AK-se të datës 10.06.2024 AK-MSH fillimisht ka rekomanduar për dhënie kontratë OE Besa Security SHPK me çmimi prej 85,795.20€. Kunder

këtij vendimi të AK-së janë dorëzuar tri ankesa në OSHP me nr: OSHP: 2024/0550 OSHP: 2024/0566 OSHP: 2024/0559. OSHP me datë 21.08.2024 ka nxjerr vendimin e panelit shqyrtues me dispozitiv si në vijim : Aprovohen, si të bazuara ankesa e OE “SAS” SH.P.K me nr. 2024/0550, e datës 26.06.2024, ankesa e OE “KSF Major” SH.A me nr. 2024/0559 e datës 28.06.2024, ankesa e OE ”Internat Security Association” SH.P.K me nr. 2024/0566 e datës 28.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-2841-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë. Anullohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës si në pikën I të dispozitivit ndërkaq AK duhet ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim. Autoriteti Kontraktues –Ministria e Shëndetësisë pas kthimit të lëndës në RIVLERËSIM me datë 18.09.2024 ka nxjerr Vendimin e AK-së ku ka rekomanduar për shpërblim me kontratë OE KSF Major SH.A me çmim të ofertës prej 73,958.40€ si ofertues i përgjegjshëm me çmim me të lirë. Paneli shqyrtues në vendimin e datës 21.08.2024 ka aprovuar të tri ankesat si të bazuara ku ndër ankesat e pranuar është edhe nga OE KSF MAJOR SH.A (OE i rekomanduar pas rivlerësimit) dhe ankesa e parashtruar nga OE Internat Security Association” SH.P.K. (OE ankues pas rivlerësimit). Sipas përshkrimit të mësipërm ekspertit shqyrtues konstatonë se AK-MSH gjatë procedurës së Rivlerësimit ka zbatuar vendimin e OSHP nr. OSHP: 2024/0550 OSHP: 2024/0566 OSHP: 2024/0559, dhe super ekspertizën e ekspertit shqyrtues duke rekomanduar për kontratë OE KSF MAJOR SH.A , si ofertues i përgjegjshëm me çmim me të ulët . Çështjet tjera në lidhje me pretendimet ankimore janë trajtuar edhe në vendimin e OSHP-se nr. 550,559 dhe 566 dhe në super ekspertizën e përgatitur nga ekspertit shqyrtues si rezultat e ankesave të lartcekura. Bazuar në përshkrimin e mësipërm , kërkesave të dosjes së tenderit, ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, vendimit të OSHP-se nr. 550,559 dhe 566 të datës 21.08.2024, super ekspertizës , nenit 6 , 7, dhe 59 të LPP-së konstatojmë se pretendimi ankimor është i pa bazuar dhe rekomandojmë panelin shqyrtues si në vijim: Ankesa e OE ankues është e pa bazuar. Të Mbetet në fuqi vendimi i AK-se pas Rivlerësimit i datës 18.09.2024.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë pjesërishtë të pranuar dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë rekomadimin nga raporti i tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërishtë të bazuara për faktin se AK- ja në NJT dhe DT tek kërkesat mbi mundësit teknike/profesionale ka kërkuar citat “Operatori ekonomik me oferte duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për orët e natës, Festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimin e OE, TVSH-ne, Totali i ofertës. OE duhet të ketë kujdes në kalkulimin e çmimeve për ore sepse çmimi për ore duhet të variojë varësisht nga ndërrimi i orarit të punës” mbarim citati. OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar analizën financiare, ku nuk figurojnë orët

e e natës, mirpo nëse i referohemi Listës -përshkrimit të çmimeve AK-ja nuk ka kërkuar me ndonjë pozicion të veçantë në përshkrimin e çmimeve për orët shtesë të natës, as festat e as vikendet. Mipro mare parasysh nenin 7 te LPPse OE i rekomanduar per kontrate ka çmimin me të ulët prej: -12,182.4 Euro.

Rrjedhimishtë Paneli shqyrtues në kuptim të nenit 1,6, 7 duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka vendosur të mbetët në fuqi B58Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Ministria e Shëndetësisë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Sigurimi Fizik i Objekteve te Institutit Special në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-2841-2-2-1.

Ndërsa kerkohet nga AK-ja që gjate implementimit të kontratës të jetë i vëmendshëm kontraktuesi që raportin mujor ta dorezoj me të dhëna -dëshmit mbi pagesat të rojëve të sigurimit.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- OE - **"Internat Security Association"SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: